



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT**  
**KËSHILLI I BASENIT UJËMBLEDHËS ISHËM – ERZEN**

---

**VENDIM**

Nr. 4 datë 7.03.2014

Për

**Miratimin e lejës për përdorim teknologjik dhe prodhim pije alkolike të rezervës ujore me pus shpimi për subjektin “TEA” Sh.p.k, ish Kombinati Misto Mame, Tiranë”.**

Në mbështetje të neneve 12, 41 pika 1 të Ligjit Nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të vendimit nr.3 datë 19.07.2002 të K.K.U, “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit të Baseneve Ujëmbledhës dhe Agjensive të Ujit”, të Vendimit Nr.1, datë 07.06.2007, të Këshillit Kombëtar të Ujit “Për miratimin e formularit tip të lejës për “Përdorim të Rezervës Ujore”, Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Ishëm-Erzen:

**V E N D O S I**

1. Miratimin e lejës për përdorim teknologjik dhe prodhim pije alkolike të rezervës ujore me pus shpimi për subjektin “TEA” Sh.p.k , Misto Mame, Tiranë.
2. Koordinatat e vendndodhjes të pusit:  
 $X = 45\ 76\ 660$                        $Y = 43\ 98\ 245$                        $Z = 105\ m$   
Thellësia e pusit të shpimit                       $h = 100\ m.$
3. Sasia e ujit që jepet në përdorim                       $Q = 0.4\ litër/sek$
4. Ngarkohet AUB Ishëm-Erzen për zbatimin e këtij vendimi.

**PËRGJEGJËSI A.U.B**  
**ISHËM – ERZEN**

Shpëtim **MEDIU**



**KRYETARI I K.B.U**  
**ISHËM – ERZEN**

Sadi **VORPSI**

